



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0979

OSHP;2023/999

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (LPP) në përbërjen; Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën e operatorit ekonomik (OE) “HIDRO PROJECT” Sh.p.k (e regjistruar me numër të protokollit 979/23) dhe ankesën e OE “MENTI” Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k (e regjistruar me numër protokollit 999/23), të parashtruara kundër Vendimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit 206-23-6380-5-1-2, iniciuar nga MINISTERIA E SHËNDETËSISË, nga cilësia e autoritetit kontraktues (AK), me 12.03.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “HIDRO PROJECT” sh.p.k e datës, 04.12.2023, (Numër Protokollit: 2023/0979), kundër, Vendimit i AK/ Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit; 206-23-6380-5-1-2.
2. Refuzohet si e pa bazuar ankesa OE MENTI Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k e datës 11.12.2024, (Numër Protokollit: 2023/0999) kundër, Vendimit i AK/ Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit; 206-23-6380-5-1-2.
3. Mbetet në fuqi, “Njoftim mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues” Ministria e Shëndetësisë, dt.20.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit 206-23-6380-5-1-2.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e operatorit ekonomik ankues “HIDRO PROJECT” Sh.p.k., ndërsa konfiskohen mjetet në shumën e deponuar në emër të taksës tarifore ndaj operatorit ekonomik ankues “MENTI” Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k, dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 26.06.2023, Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë (Procedurë e Kufizuar), lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit 206-23-6380-5-1-2.

Me 20.11.2023, AK (me të dhëna si me sipër), përmes Njoftimit – B58, ka publikuar Njoftim mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues.

Me 24.11.2023, OE “HIDRO PROJECT” Sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK, të datës 30.11.2023.

Si dhe me 27.11.2023, OE “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK, të datës 30.11.2023.

Me 04.12.2023, Operatori ekonomik “HIDRO PROJECT” Sh.p.k dhe me datën 11.12.2024 “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k., kanë parashtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, të cilat janë regjistruar me numër protokolli 979/23 dhe 999/23.

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak,

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “HIDRO PROJECT” Sh.p.k. janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se “jemi eliminuar nga gara e mëtutjeshme gjegjësisht nuk kemi kualifikuar më tutje për fazën tjetër. Arsyeja e eliminimit të grupi tonë është si më poshtë: Nuk e kemi prezantuar inxhinierin me certifikatë të efijencës së energjisë sipas kërkesës 3 të kapacitetit teknik dhe profesional në NjK dhe DT-nuk kemi ofruar asnjë dokument për dëshmi. Sa i përket kësaj arsye të eliminimit, ju konfirmojmë se ne e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht dhe këtë e argumentojmë me dëshmi konkrete. Dëshmi dokumentare është kërkuar që njëri nga inxhinierët të jetë i certifikuar për efijencë të energjisë. Ne si grup i operatorëve ekonomik “Hidro Project Shpk&Engroup Shpk me rastin e ofertimit gjegjësisht me dosje kemi bashkangjitur listën e stafit profesional të liderit Hidro Project në përbërje prej 8 inxhinierëve, e ku në numrin rendor 2 është inxhinierja znj. Arberesha Kastrati. Për inxhinieren Arberesha Kastrati ne kemi bashkangjitur me dosje, Diplomën e masterit të noterizuar dhe kontratën e punës për projektin në fjalë, mirëpo tani e kemi vërejt se për shkak të një lëshimi teknik nuk kemi bashkangjitur certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa. Pra ka qenë një lëshim teknik nga ana jonë me rastin e bashkëngjijtes së

dokumentacionit. Këtë certifikatë e kemi bashkëngjitur në projektin tjetër të zhvilluar nga ana juaj “Ndërtimi i QKMF në Drenas” dhe këtë mund ta vërtetoni nëse analizoni dokumentet tona në këtë tender (si dëshmi që ka ekzistuar kjo certifikatë para datës së fundit të dorëzimit të aplikacioneve). Si dëshmi se inxhinierja Arberesha Kastrati ka certifikatën për auditim të energjisë në ndërtesa, po ju bashkëngjisim me këtë kërkesë për rishqyrtim certifikatën e trajnimit. Certifikata në fjalë mban datën para datës së hapjes së ofertave, konkretisht trajnimi nga inxhinierja në fjalë është mbajtur nga 28 shtator deri me dt.09.12.2020. Autoritet kontraktues është dashur të veproj në harmoni me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe në harmoni me nenin 8 të Rregullores Nr.001/2022 Për prokurim publik dhe të kërkon sqarime shtesë në lidhje me mungesën e certifikatës së inxhinieres Arberesha Kastrati, ashtu siç keni kërkuar sqarime shtese për ISO Standardet 9001; sipas rregullores është dashur që të kërkohej sqarimi shtese për certifikate dhe cv dhe me pas të behet vlerësimi. Meqenëse nuk janë zbatuar dispozitat e lartpërmendura me rastin e vlerësimit të aplikacioneve atëherë me mirëkuptim kërkojmë nga ana juaj që të merret parasysh certifikata e trajnimit për auditim të energjisë në ndërtesa e znj. Arberesha Kastrati. Kjo certifikatë duhet të merret parasysh sepse i plotëson kushtet sipas nenit 72.3 të LPP-së, pasi që mund të vërtetohet në mënyrë objektive ekzistenca e saj. Duke marr për bazë të gjitha sqarimet dhe dëshmitë konkrete vijë në përfundim se nuk është respektuar edhe dispozita e nenit 47 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik sepse nuk jemi kualifikuar për fazën tjetër edhe pse i kem i plotësuar të gjitha kërkesat e fletës së të dhënave për para kualifikim të dokumentit para kualifikues. Neni 56.2.2 e përcakton qartë se numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, prandaj në këtë rast është edhe një vend i zbrazët për tu plotësuar numri maksimal prej 6 kandidatëve. Po ashtu neni 47.17. i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e përcakton që numri maksimal i kandidatëve të para kualifikuar është 6, kurse në njoftimin mbi vendimin shihet se janë para kualifikuar pesë operator ekonomik, e që domethënë për tu arritur numri maksimal i tenderuesve të para kualifikuar mund të përfshihet edhe një tenderues, e në këtë rast ne i plotësojmë të gjithë kërkesat e përshtatshmërisë dhe kërkesat minimale për kualifikim, prandaj duhet të jemi tenderuesi i 6 i kualifikuar në këtë rast. Njëkohësisht nuk është marr në konsideratë edhe neni 7 i LPP-së, pasi që paragrafi 1 i këtij neni e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “HIDRO PROJECT” Sh.p.k., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 33, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP si dhe nenin 8 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik duke kërkuar të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të kthehet lënda në rivlerësim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MENTI” Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se lidhur me eliminimin se OE nuk ka prezantuar Certifikatën e efijences për ndonjërin nga inxhinieret, AK ne DT ka kërkuar si vijon:Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efijence të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar. Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret, Kontratrat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, gjithashtu, për Menaxherin e projektit si dëshmi kërkohej - Vendim për caktimin e Menaxherit të projektit. Kërkesa 2. Stafit teknik - Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me staf teknik min. 40 punëtor, prej tyre së paku 10 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet

në punë sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë. Pretendimi ankimor: ka të bëjë lidhur me shkeljen e afateve kohore të vlerësimit, në dosjen e tenderit është theksuar që do të kualifikohen 6 operator ekonomik janë kualifikuar 5 dhe se nuk është dashur që të trajtohet fare kërkesa për rishqyrtim për operatorin ekonomik Valmir Loshi B.I. Pretendimi ankimor : Përzgjedhja në fazën tjetër kualifikuese për Gr.i OE-ve,,Termomontimi N.N & Desing SHPK & Haxha Kom SHPK Lidhur me pretendimin ankimor se Kontrata e ing.i Elektroteknikës (Afrim Prokshi) është me afat të caktuar, i njëjti nuk ka të përfunduar edhe Certifikimin për Auditim të Energjisë sipas kërkesës së AK. Pretendimit ankimor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik „AAG Projekt & Shkëmbi SHPK & Enggroup SHPK & Alping" diplomat e ing. të cilët kanë përfunduar jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara, Gr.i operatoreve ekonomik ka prezantua diplomën e ing.Kushtrim Krasniqi. Dëshmia 2. Lista e stafit teknik që do të angazhohen për kryerjen e punëve, me të dhënat në vijim; Emrin, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesioni, eksperiencën (në vite) dhe pozicionin në kompani. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë kontratë për secilin punëtor. Për punëtorët e certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë të dorëzohet kopja e Certifikatës së trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, e lëshuar nga autoriteti i licencuar sipas Ligjit për SSHP-së. Lidhur me pretendimin ankimor se i mungon Vibratori sipas kërkesës së AK në cilësinë e Gr.i operatoreve ekonomik nuk ka prezantuar listën e pasjeve pjesë e kësaj. Pretendimit ankimor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik , ALFA. " diplomat e ing. jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara, operatori ekonomik ka prezantua diplomën e ing. të arkitektues në Master të përfunduar nga Florijana Jemini po ashtu se OE e ka vetëm me kontratë listën e punëtorëve, jo të verifikueshme. Dëshmia 2. Lista e stafit teknik që do të angazhohen për kryerjen e punëve, me të dhënat në vijim Emrin, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesioni, eksperiencën (në vite) dhe pozicionin në kompani. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë kontratë për secilin punëtor. Për punëtorët e certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë të dorëzohet kopja e Certifikatës së trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, e lëshuar nga autoriteti i licencuar sipas Ligjit për SSHP-së.

Pretendimit ankimor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik ,, Gr.i OE-ve - Construmax ShPK & TOP PROJEKT ShPK & Hars Group ShPK “Kontrata e ing. të ndërtimit-konstruktiv (Bekim Rexhepi) dhe ing. Shaban Krasniqi kontratat e të cilëve janë me afat të caktuar. Pretendimit ankimor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik Gr.i OE-ve Hidro Projekt SHPK & ENGGROUP Gr.i OE-ve nuk plotëson kapacitetet teknike dhe profesionale, makineritë si dhe nuk plotëson kriterin për ing. Gjeodezis, i mungon Vibratori sipas kërkesës së AK Dëshmia 5. Lista e pajisjeve, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të pajisjeve së bashku me dëshmitë për pajisjet. Dëshmia 4. Diploma e noterizuar, CV e nënshkruar nga vet inxhinieri, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës 5 vite pas diplomimit, licenca me afat për shërbimet gjeodezike, OSE, në rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti, Licencën me afat, referencat për përvojën e punës.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “MENTI” Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 4, 6, 7, 59,

64, 65, 69, 70 71, 72, 108A të LPP duke kërkuar të aprovohet ankesa si e bazuar dhe te kthehet lënda në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 05/12/2023 dhe 13/12/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 979/23 dhe 999/23, ndërsa me datë 06/12/2023 dhe 14/12/2023 janë dorëzuar raportet e ekspertit me nr. 2023/0979 dhe 2023/0999 me rekomandimet si në vijim:

Për raportin Nr. 979/23 Eksperti rekomandon “Gjate shqyrtimit te procedurës dhe shqyrtimit te pretendimit ankimore konstaton se AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë në kuptim dhe zbatim te Nenit 72 të LPP, Nenit 38 te RrRoup nr.001/2022 dhe Nenit 10 te RrOUP Nr.001/2023 ne bazë të kësaj dhe me qëllim të respektimit të LPP-së, pretendimi ankimor i bazuar, rekomandohet të kthehet procedura në rivlerësim.”

Për raportin Nr. 999/23 Eksperti rekomandon “Duke pasur parasysh pretendimet ankimore dhe zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe legjislacionin ne fuqi ne cilësinë e ekspertit shqyrtues rekomandoj qe te refuzohet ankesa e operatorit ekonomik si e pa bazuar.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE “HIDRO PROJECT” Sh.p.k nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ndërsa “MENTI” Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k. nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues (duke paraqitur sqarimet shtesë përmes sistemit e-prokurimi).

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0979, të pretendimeve ankimore të OE “HIDRO PROJECT” Sh.p.k, ankues, si në vijim;

Eksperti Shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ne ofertën e tij ka prezantuar Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur, Diplomat e noterizuar (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose mastar), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt, lidhur me ing. znj. Arbëresha Kastrati, por i njëjti nuk ka prezantuar dokumentet, Certifikata për eficiency të energjisë, CV-të e nënshkruara nga vet inxhinieret, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, Lista e ing. e dorëzuar nga Operatorit ekonomik ne ofertën e tyre: Lista e stafit profesional, Kontrata e punës e prezantuar për ing. znj. Arbreshë Kastrati, Diploma Universitare e ing. znj. Arbëresha Kastrati. Operatori ekonomik gjatë paraqitjes se kërkesës për rishqyrtim si dëshmi ka paraqitur dokumentet e kërkuara për ing. znj. Arbëresha Kastrati dhe te cilat gjendja ekzistuese e tyre është para publikimit te Njoftimit për Kontratë. Certifikata e ing. znj. Arbëresha Kastrati për eficiency te energjisë e dërguar si dëshmi me kërkesën për ri shqyrtim nga ana e OE-së. AK me datën 10.10.2023 me anë te letrës standarde për sqarime ka kërkuar informacione shtesë nga ana e OE-së lidhur me ISO Standarde ku ka kërkuar sqarim. Por NUK kanë kërkuar sqarime lidhur me kërkesat Certifikata për eficiency të energjisë, CV-t e nënshkruara nga vet inxhinieret, Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës, si rezultat i të cilave edhe është eliminuar operatori ekonomik ne Fazën e parë me që rast është atakuar Neni 72 i LPP-së. Bazuar dhe mbështetur ne legjislacionin ne fuqi te prokurimit publik në cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave AK me rastin e eliminimit te operatorit ekonomik ankues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 72 te LPP-së, Nenin 38 te

RrOUP-së Nr.001/2022 dhe Nenin 10 te RrOUP Nr.001/2023 pasi që nuk janë kërkuar sqarime lidhur me këtë dhe ka ndikuar ne eliminimin e ofertës se OE-së. Duke pasur parasysh faktet dhe argumentet e prezantuar dhe legjislacionin ne fuqi (Neni 72 i LPP, Nenin 38 i RrOUP-së Nr.001/2022, pika 10 e RrOUP Nr.001/2023) në cilësinë e ekspertit shqyrtues pretendimin ankimore te OE marrë si të bazuar.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0999, të pretendimeve ankimore të OE "MENTI" Sh.p.k & ENGINERRING Sh.p.k, ankues, si në vijim;

Eksperti Shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh kërkesën e AK gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës se OE-së konstatoj se OE ka prezantuar ing. sipas kërkesë se DT por nuk ka para as një dokument qe dëshmon se ndonjëri nga ing. është i Certifikuar për eficiency te energjisë sipas kërkesës se dosjes se tenderit, OE as ne kërkesën për Rishqyrtim nuk ka prezantuar ndonjë dëshmi se ndonjëri nga ing. është i certifikuar me këtë certifikatë. Operatori ekonomik ankues nuk ka prezantuar listën e punëtoreve me staf teknik prej 40 punëtoreve. Me tutje çdo operator ekonomik ka te drejtën e plotë ligjore konform LPP qe te paraqes kërkesë për rishqyrtim dhe ZPP i AK-së është i obliguar qe te trajtoj çdo kërkesë për rishqyrtim andaj ZPP i AK ka vepruar ne pajtim te plotë me nenin 108/A ne rastin kur e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik Valmir Loshi B.I. Mes tjerash AK ka bërë edhe themelimin e komisionit të vlerësimit konform dispozitave ligjore te LPP-së. AK ne këto raste edhe pse ka njoftuar se munden qe te kualifikohen 6 operator dhe i ka kualifikuar vetëm 5 për fazën tjetër nuk është ndonjë shkelje ligjore ne këtë rast sepse vlerësimi i ofertave bëhet konform kriterëve te përcaktuara nga ana e AK, dhe parimisht mund te kualifikohen 2, 3 dhe 6. Është përgjegjësi, e Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe Aneksin 7 në dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret kulifikuese. Pas analizimit komplet dokumentacionit të ofruar nga Gr. i OE-ve „Termomontimi N.N & Desing SHPK & Haxha Kom SHPK dhe kam vërejtur se Gr. i OE kanë prezantuar dokumentin që dëshmon se posedojnë Vibratorin sipas kërkesës se DT. Andaj bazuar ne këtë pretendimi ankimor se Gr. i OE nuk posedojnë dëshmi për Vibratorin në bazë të dokumenteve te analizuar ne cilësinë e eksperti shqyrtues konsideroj se është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se Kontrata e ing. i Elektroteknikës (Afrim Prokshi) është me afat te caktuar eksperti shqyrtues sqaron, se kontrata e ing. Afrim Prokshi është e nënshkruar me datën 01.4.2023 dhe e njëjta është fuqi ende, dhe e njëjta plotëson kriterin e kërkuar nga AK, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar. I njëjti ka te përfunduar edhe Certifikimin për Auditim te Energjisë sipas kërkesës se AK-së. autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit nuk ka kërkuar qe diplomat e ing. Lidhur me pretendimin ankimore se i mungon Vibratori sipas kërkesës se AK ne cilësinë e ekspertit konstatoj se Gr. i operatoreve ekonomik ka prezantuar listën e pasjeve pjesë e kësaj liste është edhe Vibratori, po ashti i njëjti AK dorëzuar edhe Faturën me nr.028177 ne emrin e partnerit te grupi „Shkëmbi SHPK" që dëshmon se grupi i OE-ve plotëson kriterin e kërkuar nga ana e AK dhe se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit se Gr. i OE-ve e ka vetëm me kontrata listën e punëtoreve, jo te verifikueshme, eksperti shqyrtues sqaron se AK ne dosjen e tenderit ka kërkuar si vijon: Dëshmia 2. Lista e stafit teknik qe do të angazhohen për kryerjen e punëve, me të dhënat në vijim Emrin, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (në vite) dhe pozicioni në kompani. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë kontratë për secilin

punëtor. Për punëtorët e certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë të dorëzohet kopja e Certifikatës së trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, e lëshuar nga autoriteti i licencuar sipas Ligjit për SSHP-së. Andaj bazuar në këtë Gr. i operatoreve ekonomik ka prezantuar listën e stafit konform kërkesës se AK kurse AK ne baze të LPP mundet që gjatë vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit që ku do që e shihet të arsyeshme ose nevojshme që ta verifikoj andaj pretendimi ankimore se Gr i OE-ve listën e ka vetëm me kontratë nuk qëndron pasi që të njëjtin kanë çdo dokument tjetër të kërkuar në kërkesën e AK-së, të njëjtit kanë edhe Certifikatat për siguri dhe shëndet në punë dhe kontratat e punës:

Si dëshmi po i paraqes listën e punëtorëve dhe disa Certifikata për siguri dhe shëndet në punë. Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit nuk ka kërkuar që diplomat e ing. të cilët kanë përfunduar jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuar, operatori ekonomik ka prezantuar diplomën e ing. të arkitekturës në Master të përfunduar nga Florijana Jemini.

E njëjta diplomë është konform kërkesave të AK-së, nr. serik i diplomës 000503 titulli i diplomës Master i shkencave në arkitekturë i përfunduar në Universitetin EPOKA në Shqipëri, e njëjta përmban edhe noterizim nga ana e noterit, andaj bazuar në kërkesën e AK në cilësinë e ekspertit konsideroj dhe konstatoj se e njëjta plotëson kriterin e kërkuar nga AK dhe pretendimi ankimore lidhur me këtë pikë është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE e ka vetëm me kontrata listën e punëtorëve, jo të verifikueshme, eksperti shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit ka kërkuar si vijon: Dëshmia 2. Lista e stafit teknik që do të angazhohen për kryerjen e punëve, me të dhënat në vijim Emrin, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesionin, eksperiencën (në vite) dhe pozicionin në kompani. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë kontratë për secilin punëtor. Për punëtorët e certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë të dorëzohet kopja e Certifikatës së trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, e lëshuar nga autoriteti i licencuar sipas Ligjit për SSHP-së. Andaj bazuar në këtë OE ka prezantuar listën e stafit konform kërkesës se AK kurse AK në baze të LPP Nenit 59 mundet që gjatë vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit që ku do që e shihet të arsyeshme ose nevojshme që ta verifikoj andaj pretendimi ankimore se Gr i OE-ve listën e ka vetëm me kontratë nuk qëndron pasi që të njëjtin kanë çdo dokument tjetër të kërkuar në kërkesën e AK-së, të njëjtit kanë edhe Certifikatat për siguri dhe shëndet në punë dhe kontratat e punës: Si dëshmi po i paraqes listën e punëtorëve dhe disa Certifikata për siguri dhe shëndet në punë. Operatori ekonomik në ofertën e tij dhe dokumentacionin e tij ka prezantuar më tepër se sa 3 vibrator të dëshmuar me Duda doganor, Fatura dhe Kontrata të shitblerjes, dhe bazuar në këtë pretendim ankimore se nuk posedon vibrator është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se Kontrata e ing. të ndërtimit-konstruktiv (Bekim Rexhepi) dhe ing. Shaban Krasniqi kontratat e të cilëve janë është me afat të caktuar eksperti shqyrtues sqaron, se kontrata e ing. Bekim Rexhepi është e nënshkruar me datën 25.01.2023 dhe e njëjta është fuqi ende, dhe e njëjta plotëson kriterin e kërkuar nga AK, po ashtu kontrata e ing. Shaban Krasniqi është e nënshkruar me datën 03.01.2023 dhe është po ashtu ende në fuqi dhe aktive, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar. Po ashtu duke pasur parasysh se AK ka kërkuar Kontrate ose Para kontrate, në rastin kur aktiviteti mundet të stërzgjatet lidhur me këto çështje AK konform Nenit 59 dhe 72 mundet që të kërkojë sqarime dhe plotësim të lidhur me këto.

Pretendimi ankimore se Gr. i OE-ve nuk plotëson kapacitetet teknike dhe profesionale, makineritë (pasi që ka marrëveshje për përdorim të tyre) si dhe nuk plotëson kriterin për ing. Gjeodezisë nuk qëndrojnë pasi që AK në dosjen e tenderit tek Dëshmia nr.5 për makineritë ka kërkuar si në vijim po ashtu tek Dëshmi nr.4 për stafi ka kërkuar si në vijim: Dëshmia 5. Lista e pajisjeve, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të pajisjeve së bashku me dëshmitë për pajisjet. Dëshmia 4. Diploma e noterizuar, CV e nënshkruar nga vet inxhinieri, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt, Referencat për përvojën e punës 5 vite pas diplomimit, licenca me afat për shërbimet gjeodezike, OSE, në rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti, Licencën me afat, referencat për përvojën e punës.

Bazuar në këtë në cilësinë e ekspertit shqyrtues sqarojmë se dokumentacioni i ofruar nga OE është konform kërkesave të dosjes së tenderit pasi që për të njëjta OE ka prezantuar dëshmitë në ofertë, marrëveshjet për përdorim të mjeteve në rast se shpërblehet me kontratën. Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit nuk ka kërkuar që diplomat e ing. të cilët kanë përfunduar jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuar.

Lidhur me pretendimin ankimore se i mungon Vibratori sipas kërkesës së AK në cilësinë e ekspertit konstatoj se Gr. i operatoreve ekonomik ka prezantuar listën e pajisjeve pjesë e kësaj liste është edhe Vibratori, po ashtu i njëjti e ka dorëzuar edhe Kontratën e shitblerjes së vibratorit dhe marrëveshjen e përdorimit të pajisjeve, që dëshmon se e grupi i OE-ve plotëson kriterin e kërkuar nga ana e AK dhe se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatoreve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues " "HIDRO PROJECT" SH.P.K janë të bazuara ndërsa pretendimet e operatoreve ekonomik ankues MENTI Sh.p.k & ENGINEERING GROUP sh.p.k janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme

për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raportet e ekspertit shqyrtues, janë hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, dhe përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues për ankesën e parashtruar me numër protokolli: 2023/0979, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar nga eksperti me kërkesën panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të operatori ekonomik “HIDRO PROJECT” sh.p.k , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit; 206-23-6380-5-1-2, të autoritetit kontraktues, Ministria e Shëndetësisë.

Paneli vëren se OE ankues kundër këtij aktiviteti ka paraqitur vetëm një (1) pretendim ankimor sipas të cilit pohon se për znj. Arbëresha Kastrati, nuk e ka prezantuar dokumentin, Certifikatën për efikasitet të energjisë në ofertën e tij, e cila ka qene kërkesë e Dosjes se Tenderit.” Kërkesa3.;Kapaciteti teknik dhe profesional, Dëshmia 3. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur - Certifikata për efikasitet të energjisë, për njërin nga inxhinierët e kërkuar”. Eksperti shqyrtues ka vlerësuar se edhe pse ankuesi nuk e ka dorëzuar dokumentin në fjalë në ofertën e tij me kohë, sipas kërkesës së DT, Autoriteti Kontraktues në këtë rast Ministria e shëndetësisë, në bazë të nenit 72 të LPP-së, ka mund të ftojë operatorin ekonomik për të plotësuar dokumentet e paraqitura, të cilat nuk i ka paraqitur me kohën e caktuar sipas afatit të Dosjes së Tenderit.

Paneli shqyrtues bazuar në dokumentin Dosja e Tenderit (Procedure e Kufizuar)i datës 26.06.2023 dhe në Njoftim mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues” Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit 206-23-6380-5-1-2., vrene, se në këtë aktivitet prokurimi kanë shprehur interesim 17 operator ekonomik, ndërsa autoriteti kontraktues me vendimin e tij të datës 20.11.2023, i ka përzgjedhur/kualifikuar 5 operator ekonomik, ndërsa të tjerët janë eliminuar për arsyeje të mosplotësimit të kërkesave të Dosjes se tenderit(Procedurë e Kufizuar) në këtë rast janë eliminuar edhe të dy ankuesit. Paneli shqyrtues në këtë kontest i falë besimin e provës dokumentit të Autoritetit kontraktues, B54-Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës, 20.11.2023, përmes të cilës i ka njoftuar ankuesin “HIDRO PROJECT” sh.p.k , për arsyen e eliminimit të tij si në vijim:

ARSYETIM

Nuk e keni prezantuar Inxhinierin me Certificate te efqences se energjisë sipas kërkesës 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional ne NJK dhe DT - nuk keni ofruar asnjë dokument për dëshmi.

Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë në këtë aktivitet te prokurimit bazuar në faktin e ofertimit të operatorëve ekonomik të cilët kanë plotësuar kërkesat e Dosjes se tenderit(Procedurë e Kufizuar), AK sipas diskretcionit të tij ligjor “mund” nuk e ka pa të nevojshme që sipas nenit 72 LPP-se, të kërkojnë plotësim te dokumenteve të ofertimit ndaj ankuesit, nga fakti i operatorëve që kane ofertuar me dokumente të kompletuara sipas kërkesës se DT. Andaj Paneli shqyrtues bazuar ne faktet e paraqitura me larte konstaton se dispozita e cituar me larte ligjore është një mundësi e autoritetit kontraktues, por jo një detyrim i tij ligjor, për këtë pretendimi ankuesit është i pjesërishëm, pa ndikim në rezultat të këtij aktiviteti prokurimi dhe mbetjes në fuqi të vendimit të AK-së.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën nr. 0999/2024, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar me kërkesën panelit për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të Operatori ekonomik “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k, të parashtruar lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit; 206-23-6380-5-1-2, të autoritetit kontraktues, Ministria e Shëndetësisë.

Paneli vëren se OE ankues kundër këtij aktiviteti ka paraqitur pretendime ankimore e të cilat janë vlerësuar nga ana e ekspertit shqyrtues me raportin e tij të datë 14/12/2023, i cili i është dorëzuar Panelit shqyrtues, sipas të cilit të gjitha pretendime ankimore janë vlerësuar si të pabazuara.

Paneli shqyrtues vlerëson si të panevojshme që edhe njëherë të elaborohet bazushmëria ligjore e pretendimeve ankimore të Operatori ekonomik ankues “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k, andaj Paneli i mbështet si ligjore, si gjetje të tija, të gjitha konstatimet e Raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues, me rekomandimin për refuzim të ankesës dhe mbetjes në fuqi të vendimit të AK-së.

Paneli shqyrtues po ashtu i falë besimin e provës dokumentit të Autoritetit kontraktues, përmes B54-Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës, 20.11.2023, përmes te cilës ka njoftuar ankuesin“MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k për arsyet e eliminimit të tij si në vijim:

ARSYETIM

Nuk e keni plotësuar kërkesën nr. 2 te Kapaciteti teknik dhe profesional – Nuk e keni plotësuar stafin teknik min. 40 punëtor sipas dëshmime te kërkuara. Lideri i konsorciumit Menti Sh.p.k. i plotëson me dëshmi 20 punëtor, kontratat e punës për 7 punëtor janë me data te skaduara 31.03.2023 d.m.th. para hapjes se tenderit. Anëtari i konsorciumit Engineering Group SH.P.K. i plotëson me dëshmi 8 punëtor. Gjithsejtë me dëshmi oferta juaj e plotëson numrin e stafit teknik vetëm për 28 punëtor.

Nuk e keni prezantuar Inxhinierin me Certificate te efqences se energjisë sipas kërkesës 3 te Kapaciteti teknik dhe profesional - nuk keni ofruar asnjë dokument për dëshmi.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës , ka gjetur se ankesa OE “HIDRO PROJECT” Sh.p.k., aprovohet si pjesërisht bazuar ndërsa refuzohet si e pa bazuar ankesa “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k, pasi ankuesit nuk kanë arritur të dëshmojnë me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Paneli shqyrtues ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit/Procedure e kufizuar, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit;206-23-6380-5-1-2, të autoritetit kontraktues, Ministria e Shëndetësisë.

Përfundimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, “Njoftim mbi Vendim i Autoritetit Kontraktues” Ministria e Shëndetësisë, dt.20.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF në Istog” me numër të prokurimit 206-23-6380-5-1-2.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës së operatorit ekonomik “HIDRO PROJECT” Sh.p.k., vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa operatorit ekonomik “MENTI” Sh.p.k & ENGINERRING GROUP sh.p.k, bazuar në faktin e refuzimit të ankesës tij, vendosi t,i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - HIDRO PROJECT SH.P.K., „Menti Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: